



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KËRKESË PËR OFERTË PËR INDIVID/SUBJEKT PËR EKSPERTIZË STATISTIKE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) po zbaton nismën “Monitorimi i të drejtave dhe lirive themelore gjatë pandemisë globale Covid-19 dhe fuqizimi i shoqërisë civile në Shqipëri,, mbështetur financiarisht nga the Balkan Trust for Democracy dhe USAID.

Kjo nisëm synon të monitorojë kufizimet ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut që u kryen gjatë pandemisë Covid.19, duke u fokusuar më së shumti ndaj të drejtave të edukimit dhe social-ekonomike dhe lirisë së lëvizjes dhe tubimit. Në kuadër të këtij synimi, një ndër aktivitetet thelbësore të nismës përfshin mbledhjen e të dhënave nga qytetarët dhe institucionet nëpërmjet pyetësorëve të përgatitur. KShH shpall kërkesën për ofertë për ekspertë për t'u angazhuar në analizimin e të dhënave statistikore të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve.

Analizimi i të dhënave duhet të përfshijë karakteristikat e mëposhtme, jo shteruese:

- Përgatitja e metodologjisë së kërkimit dhe vrojtimit
- Hartimi i shembullit
- Gjenerimi i kontakteve të detajuara
- Përgatitja e pyetësorit dhe listës së indikatorëve
- Punë në terren
- Hedhje të dhënash dhe validim
- Analizë të dhënash dhe raportim (analizë në thellësi, grafik, përmbledhje, rekomandime)

KShH nxit aplikimet nga kandidatët të cilët plotësojnë karakteristikat e mëposhtme:

Aftësi individuale

- Të gëzojë integritet profesional dhe paanshmëri
- Të ketë aftësi shumë të mira analitike dhe teknike
- Të respektojë detyrat dhe afatet e vendosura nga ekipi zbatues i projektit
- Të jetë i/e aftë të punojë nën presionin e kohës
- Të jetë i/e aftë të ekzaminojë dhe përvetësojë konceptet teknike

Kritere profesionale për aplikant individ:

- Të ketë përfunduar studimet në shkenca ekonomike, matematikore apo të ngjashme tek cilat janë zbatuar kurrikula statistikore
- Të ketë përvojë profesionale 7-vjeçare
- Të ketë njohuri shumë të mira në metodologji statistikore



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Të zotërojë aftësi shumë të mira kompjuterike të programimit, kryesisht në fushën e sondazheve

Kritere profesionale për aplikant subjekt

- Të zotërojë përvojë profesionale 5-vjeçare
- Te ketë status aktiv NIPT-i

KShH fton ekspertët e interesuar të dërgojnë në formë elektronike në adresën e email-it office@ahc.org.al dokumentacionin e mëposhtëm deri më datë **22 Nëntor 2021**:

1. CV/Portfolio
2. Diplomë (në rast kandidati individ)
3. Listë elektronike me produkte të ngjashme
4. Certifikatë regjistrimi (në rast subjekti)
5. Ofertë financiare (nuk duhet të kalojë vlerën prej 1,500 Dollarë)